



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

REPUBLIC OF KOSOVO
ARRU
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
Regulatorni Autoritet za Usluge Vode
Water Services Regulatory Authority

Nr. prot./Prot. Br./ Prot. No. 586
Njësia/Jedinica/Unit D
Nr. shifres./Upis. Br./Req. No.
Data/Datum/Date 08.09.2026
PRISTINE

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, duke u mbështetur në nenin 4 paragrafi 3.1, nenin 16 dhe nenin 17 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si dhe në nenin 4, nenin 9, nenin 12 dhe nenin 13 të Rregullores Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, pas shqyrtimit të aplikacionit me nr. 525/DL, datë 10.08.2026, të KRU “Hidrodrini” Sh.A., me seli në Pejë, për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, me datën 08.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit

1. APROVOHET aplikacioni i KRU “Hidrodrini” Sh.A. me nr. 525/DL, datë 10.08.2026, për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit.
2. PËRTËRIHET/VAZHDOHET Licenca e Shërbimit e KRU “Hidrodrini” Sh.A. dhe i lëshohet Licenca e Shërbimit me nr. L-09/2026-03, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 11.09.2026 deri më 10.09.2031.
3. KRU “Hidrodrini” Sh.A., me Licencën e Shërbimit nr. L-09/2026-03, autorizohet për ofrimin e shërbimeve sipas kategorive në vijim:
 - 3.1. Kategoria A – Shërbimet e Ujësjiellësit;
 - 3.2. Kategoria B – Shërbimet e Kanalizimit;
 - 3.3. Kategoria C – Shërbimet e Ujërave të Ndotura.
4. KRU “Hidrodrini” Sh.A. autorizohet të ofrojë shërbimet për të cilat licencohet në zonën e shërbimit, e cila përfshin komunat:
 - 4.1. Pejë;
 - 4.2. Deçan;
 - 4.3. Istog;
 - 4.4. Klinë; dhe
 - 4.5. Junik.
5. KRU “Hidrodrini” Sh.A. obligohet që shërbimet për të cilat licencohet t’i ofrojë në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Rregulloren Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, aktet e nxjerra nga ARRU dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
6. KRU “Hidrodrini” Sh.A., gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Licencës së Shërbimit, obligohet të ruajë dhe përmbushë kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave është bërë përtëritja/vazhdimi i Licencës së Shërbimit.
7. KRU “Hidrodrini” Sh.A. obligohet që, me prioritet dhe urgjencë, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme teknike, operative dhe organizative për përmirësimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë

së ujit të pijshëm dhe rikthimin e saj në përputhje me standardet e aplikueshme, me vëmendje të veçantë në zonën e shërbimit të Komunës së Klinës dhe në pjesët e prekura të zonës së shërbimit të Komunës së Deçanit, ku janë evidentuar mospërputhje me standardet e cilësisë së ujit.

8. Përbushja e obligimeve të përcaktuara në pikën 7 të këtij vendimi do të jetë objekt i monitorimit të vazhdueshëm nga ARRU gjatë periudhës së vlefshmërisë së Licencës së Shërbimit, duke përfshirë masat e ndërmarra nga KRU "Hidrodrini" Sh.A., rezultatet e analizave pasuese dhe përbushjen e detyrimeve për informim sipas legjislacionit në fuqi. Nëse konstatohet se mospërbushja e standardeve të cilësisë vazhdon për periudhën e përcaktuar me legjislacionin në fuqi, ARRU do të ndërmarrë masat rregullatore përkatëse, përfshirë, sipas rastit, masat që lidhen me tarifen e shërbimit për konsumatorët e prekur, deri në rikthimin e cilësisë së ujit në përputhje me standardet e aplikueshme.

8. KRU "Hidromorava" Sh.A obligohet të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Memorandumi i Mirëkuptimit, i bashkëngjitur këtij vendimi, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në të, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përbushjen e tyre brenda afateve të parapara.

9. Licenca e Shërbimit me nr. L-09/2026-03 i bashkëngjitet këtij vendimi dhe përbën pjesë përbërëse të tij.

ARSYETIM

KRU "Hidrodrini" Sh.A., me seli në Pejë, si ofrues ekzistues i licencuar i shërbimeve të ujit, ka paraqitur pranë Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) aplikacionin për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, së bashku me dokumentacionin dhe dëshmitë përkatëse të kërkuara për zhvillimin e procedurës së licencimit.

Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit përcakton procedurën dhe kushtet për aplikimin dhe përtëritjen e licencës së shërbimit, ndërsa Rregullorja Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit përcakton procedurat, kriteret dhe kushtet konkrete për përtëritjen/vazhdimin e licencës së shërbimit. Në veçanti, neni 12 i Rregullores Nr. 16/2025 përcakton kushtet për përtëritjen/vazhdimin e licencës së shërbimit, ndërsa neni 13 përcakton vendimmarrjen e Autoritetit pas shqyrtimit të aplikacionit.

Në zbatim të këtyre dispozitave, aplikacioni dhe dokumentacioni i KRU "Hidrodrini" Sh.A. i janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për përtëritjen/vazhdimin e licencave të shërbimit. Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar dhe ka vlerësuar përbushjen e kushteve të licencës, kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për përtëritjen/vazhdimin e saj, duke përfshirë kapacitetet profesionale, teknike, operative, financiare dhe administrative të ofruesit.

Gjatë procesit të shqyrtimit është vlerësuar përbushja e kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, përfshirë përgjegjësinë e KRU "Hidrodrini" Sh.A. për ofrimin e shërbimeve në zonën e saj të shërbimit, respektimin e kushteve të licencës ekzistuese dhe përbushjen e standardeve të aplikueshme të shërbimit.

Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë i është kushtuar cilësisë së ujit të pijshëm. Neni 21, paragrafi 2.1.1 i Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit përcakton se standardet e shërbimit për ujësjellës përfshijnë cilësinë e ujit sipas standardeve të përcaktuara nga organet kompetente shëndetësore, ndërsa

neni 22 i këtij Ligji përcakton se ofruesi i shërbimeve duhet gjatë tërë kohës të jetë në pajtueshmëri me standardet e zbatueshme të shërbimit.

Në kuadër të shqyrtimit të aplikacionit, ARRU ka marrë në konsideratë rezultatet laboratorike të cilësisë së ujit, të shoqëruara me interpretimin përkatës të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), përfshirë letrën konfirmuese të datës 14.08.2026 lidhur me monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm për muajin korrik 2026. Nga rezultatet dhe interpretimi i IKSHPK-së janë evidentuar mospërputhje me standardet e aplikueshme të cilësisë së ujit, të shprehura më theksueshëm në zonën e shërbimit të Klinës dhe në një pjesë më të kufizuar të zonës së shërbimit të Deçanit. ARRU i ka trajtuar me vëmendje të veçantë këto gjetje, duke pasur parasysh se siguri i cilësisë së ujit përbën një nga kërkesat thelbësore të ofrimit të shërbimeve të ujit dhe një detyrim të vazhdueshëm të ofruesit të licencuar.

Megjithatë, duke marrë parasysh rëndësinë jetike dhe publike të vazhdimësisë së furnizimit me ujë për popullatën, si dhe pasojat që ndërprerja apo cenimi i vazhdimësisë së këtij shërbimi do të mund të shkaktonte për nevojat themelore dhe kushtet higjieno-sanitare të banorëve në zonën e shërbimit, ARRU ka vlerësuar se mospërputhjet e evidentuara nuk duhet të rezultojnë në mosvazhdimin e Licencës së Shërbimit. Përkundrazi, përtëritja/vazhdimi i licencës duhet të shoqërohet me obligimin e KRU “Hidrodrini” Sh.A. që, me prioritet dhe urgjencë, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme teknike, operative dhe organizative për përmirësimin e cilësisë së ujit dhe rikthimin e saj në përputhje me standardet e aplikueshme, me vëmendje të veçantë në zonën e shërbimit të Klinës dhe në pjesët e prekura të zonës së shërbimit të Deçanit.

Në përputhje me nenin 10 të Rregullores Nr. 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, KRU “Hidrodrini” Sh.A. mbetet e obliguar që, në rastet kur cilësia e ujit të pijshëm bie nën standardet e aplikueshme, të informojë menjëherë IKSHPK-në dhe ARRU-në, të ndjekë vlerësimet dhe udhëzimet e IKSHPK-së, të informojë konsumatorët e zonave të prekura dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për sanimin e problemit. Kompania duhet të identifikojë shkaqet dhe pikat konkrete të prekura, të zbatojë masat përmirësuese dhe të përcjellë efektivitetin e tyre përmes analizave pasuese.

ARRU, gjatë monitorimit të përmbushjes së kushteve të Licencës së Shërbimit, do ta trajtojë përmirësimin dhe ruajtjen e cilësisë së ujit në këto zona si çështje me prioritet të veçantë, duke verifikuar rezultatet e analizave pasuese, masat e ndërmarra nga KRU “Hidrodrini” Sh.A. dhe përmbushjen e detyrimeve për informimin e IKSHPK-së, ARRU-së dhe konsumatorëve të zonave të prekura.

Nëse gjatë monitorimit konstatohet se mospërmbushja e standardeve të cilësisë vazhdon për periudhën e përcaktuar me legjislacionin në fuqi, ARRU do të ndërmarrë masat rregullatore përkatëse, përfshirë, sipas rastit, masat që lidhen me tarifën e shërbimit për konsumatorët e prekur, deri në rikthimin e cilësisë së ujit në përputhje me standardet e aplikueshme.

Në përputhje me nenin 4 të Rregullores Nr. 16/2025, në bazë të aplikacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, KRU “Hidrodrini” Sh.A. autorizohet për ofrimin e shërbimeve të Kategorisë A – Shërbimet e Ujësjetillës, Kategorisë B – Shërbimet e Kanalizimit dhe Kategorisë C – Shërbimet e Ujërave të Ndotura, në zonën e shërbimit që përfshin komunat Deçan, Istog, Junik, Klinë dhe Pejë. Këto kategori dhe zona përputhen me të dhënat e dokumentacionit të licencimit.

Pas përfundimit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacionit, dokumentacionit dhe dëshmive të paraqitura, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për përtëritjen/vazhdimin e licencave të shërbimit ka vlerësuar

se KRU "Hidrodrini" Sh.A. i plotëson kushtet dhe kriteret për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit. Duke marrë parasysh njëkohësisht rëndësinë thelbësore të cilësisë së ujit dhe domosdoshmërinë e vazhdimësisë së furnizimit me ujë për popullatën, Komisioni i ka rekomanduar ARRU-së përtëritjen/vazhdimin e licencës, me obligimin që përmirësimi i cilësisë së ujit në zonat e lartcekura të trajtohet me prioritet dhe urgjencë dhe të jetë objekt i monitorimit të vazhdueshëm nga ARRU.

ARRU, duke marrë për bazë aplikacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, rezultatet e procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore dhe rregullative, rekomandimin e Komisionit, si dhe nevojën për të siguruar vazhdimësinë e një shërbimi me rëndësi jetike dhe publike, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit të KRU "Hidrodrini" Sh.A. Përtëritja/vazhdimi i licencës nuk e zbeh detyrimin e kompanisë për përmbushjen e standardeve të cilësisë së ujit; përkundrazi, obligimet e përcaktuara në dispozitiv të këtij vendimi do të jenë objekt i monitorimit të vazhdueshëm dhe, sipas rastit, i masave rregullatore nga ARRU.

Për arsyet e cekura më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- Arkivit të ARRU-së;
- KRU "Hidrodrini";
- Të gjitha Departamenteve të ARRU;
- Njesisë për Inspektim.

Zv. Drejtor

Abedin AZIZI

